<p>tjera të parapara me ligjet dhe rregullat në fuqi;</p> <p>3.7. Kohën normale javore të punës,</p> <p>3.8. Kushtet për prishje të kontratës,</p> <p>3.9. Kushtin për të shërbyer në tërë territorin.</p> <p>4. Punonjësit operativë që nënshkruajnë kontratat e punës me IPK-në, i nënshtrohen fazës së trajnimeve themelore dhe periudhës provuese.</p> <p><b>KAPITULLI III PROCEDURAT E PUNËSIMIT PËR PERSONELIN ADMINISTRATIV DHE MBËSHTETËS</b></p> <p><b>Neni 27 Procedura e punësimit</b></p> <p>Procedurat që kanë të bëjnë me kushtet e punësimit dhe të punës për punonjësit e strukturës mbështetëse në IPK, rregullohen me Ligjin për Shërbimin Civil të Kosovës dhe aktet tjera në fuqi për shërbyesit civil.</p>	<p>other benefits provided by the laws and regulations in force;</p> <p>3.7. Normal weekly working time,</p> <p>3.8. Conditions related to contract termination,</p> <p>3.9. Conditions related to deployment in the entire territory.</p> <p>4. Operation employees who sign employment contracts with KPI shall undergo basic training stage and probation period.</p> <p><b>CHAPTER III EMPLOYMENT PROCEDURES FOR THE ADMINISTRATIVE AND SUPPORT STAFF</b></p> <p><b>Article 27 Employment procedure</b></p> <p>Procedures related to employment and work of employees assigned to KPI support structures, are governed by the Law on the Civil Service in Kosovo, and other legislation for civil servants.</p>	<p>beneficije predviđene zakonima i propisima na snazi;</p> <p>3.7. Normalno radno vreme tokom nedelje;</p> <p>3.8. Uslove za poništenje ugovora,</p> <p>3.9. Uslov da će služiti na celoj teritoriji.</p> <p>4. Operativni radnici koji potpišu ugovore o radu sa PIK-om, će podleći osnovnoj fazi obuke i probnog perioda.</p> <p><b>POGLAVLJE III PROCEDURE ZAPOŠLJAVANJA ZA ADMINISTRATIVNO I POMOĆNO OSOBLJE</b></p> <p><b>Član 27 Procedura zapošljavanja</b></p> <p>Procedure koje se odnose na uslove zapošljavanja i rada za pomoćno osoblje u PIK, uređuju se Zakonom o civilnoj službi Kosova i drugim aktima na snazi za civilne službenike.</p>
---	---	--

<b>KAPITULLI IV</b> <b>ECURIA NË KARRIERË</b>	<b>CHAPTER IV</b> <b>CAREER DEVELOPMENT/PROMOTION</b>	<b>POGLAVLJE IV</b> <b>NAPREDAK U KARIJERI</b>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 28</b> <b>Puna provuese</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 28</b> <b>Probation work</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 28</b> <b>Probni rad</b></p>
<p>1. Punonjësit operativë të IPK-së që krijojnë marrëdhënie pune me IPK-në, i nënshtrohen një periudhe trajnuese gjashtë (6) mujore dhe të punës provuese gjashtë (6) mujore, gjithsej periudhës kohore një (1) vjeçare.</p> <p>2. Nga momenti i nënshkrimit të kontratës, punonjësi operativ i IPK-së duhet të jap betimin zyrtar, teksti i të cilit miratohet nga Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së.</p> <p>3. Gjatë periudhës provuese, punonjësit operativ i nënshtrohen Programit trajnues gjashtë (6) mujor në disa fusha përkatëse.</p> <p>4. Pas përfundimit të trajnimit, bëhet certifikimi i punonjësit operativ. Organi kompetent lëshon një certifikatë që përmban këto të dhëna:</p> <p style="padding-left: 40px;">4.1. Emrin e organit apo institucionit që lëshon certifikatën;</p> <p style="padding-left: 40px;">4.2. Emërtimin e certifikatës;</p> <p style="padding-left: 40px;">4.3. Titullin e temës së trajnimit;</p>	<p>1. Operation employees of KPI who establish working relationships with KPI undergo a six (6) months training period, and six (6) months probation period, or total period of one (1) year.</p> <p>2. From the moment of signing the contract, the operation employees of KPI must take the official oath, the text of which is approved by the Chief Executive Officer of KPI.</p> <p>3. During the probationary period, the operation employee undergoes a training program of six (6) months in several relevant areas.</p> <p>4. Following the completion of the training, to the operation employee shall be handed a certificate. The competent authority shall issue a certificate containing the following information:</p> <p style="padding-left: 40px;">4.1. The name of the body or institution that issues the certificate;</p> <p style="padding-left: 40px;">4.2. Denomination of certificate;</p> <p style="padding-left: 40px;">4.3. Training subject;</p>	<p>1. Operativni radnici PIK-a koji uspostave radne odnose sa PIK-om, prolaze kroz period obuke od šest (6) meseci i probnog rada od šest (6) meseci, u ukupnom trajanju od jedne (1) godine.</p> <p>2. Od trenutka potpisivanja ugovora, operativni radnik PIK-a mora da zvanično polaže zakletvu, čiji tekst je usvojen od strane izvršnog direktora PIK-a.</p> <p>3. Tokom probnog perioda, operativni radnici podležu Programu obuke od šest (6) meseci u nekim odgovarajućim oblastima.</p> <p>4. Po završetku obuke, vrši se sertifikacija operativnog radnika. Nadležni organ izdaje sertifikat koji sadrži sledeće podatke:</p> <p style="padding-left: 40px;">4.1. Naziv organa ili institucije koja izdaje sertifikat;</p> <p style="padding-left: 40px;">4.2. Nazivanje sertifikata;</p> <p style="padding-left: 40px;">4.3. Naslov teme obuke;</p>



<p>4.4. Emrin e punonjësit që i lëshohet certifikata;</p> <p>4.5. Kohëzgjatjen e Programit trajnues;</p> <p>4.6. Datën e certifikimit;</p> <p>4.7. Zyrtarin kompetent që lëshon certifikatën.</p> <p>5. Pas certifikimit, punonjësi operativ i nënshtrohet fazës së dytë të punës provuese prej gjashtë (6) muajve, që së bashku me fazën e trajnimit nuk zgjatë më shumë se një (1) vit.</p> <p>6. Gjatë periudhës provuese, punonjësit operativ i bëhen vlerësime periodike nga mbikëqyrësi. Në përfundim të periudhës provuese, kryhet një vlerësim përfundimtar i të arriturave të punonjësit.</p> <p>7. Në fund të periudhës provuese, me propozimin e mbikëqyrësit, Kryeshefi Ekzekutiv vendosë për:</p> <p>7.1. Konfirmimin e punonjësit si pjesë e strukturës, pasi ai vlerësohet i aftë për të marrë për sipër realizimin e detyrës (rezulton nënshkrimi i aktit të përhershëm të marrëdhënies së punës);</p> <p>7.2. Lirimin e punonjësit si pjesë e</p>	<p>4.4. Name of the employee who issued the certificate;</p> <p>4.5. The duration of the training program;</p> <p>4.6. Date of certification;</p> <p>4.7. The competent officer who issues the certificate.</p> <p>5. After certification, the operation employee undergoes the second stage of probation work of six (6) months, together with the training stage that lasts no longer than one (1) year.</p> <p>6. Upon probationary period, the supervisor shall conduct periodic evaluations against operation employee.</p> <p>7. At the end of the probation period, by the proposal of the supervisor, the Chief Executive Officer decides for:</p> <p>7.1. Confirmation of the employee as part of the structure, because he/she is considered capable to take over the task (resulting in signing of the permanent employment act);</p> <p>7.2. The release/dismissal of employees as</p>	<p>4.4. Ime zaposlenog kome se izdaje sertifikat;</p> <p>4.5. Trajanje programa obuke;</p> <p>4.6. Datum sertifikacije;</p> <p>4.7. Nadležni službenik koji izdaje sertifikat.</p> <p>5. Posle sertifikacije, operativni radnik podleže drugoj fazi probnog rada od šest (6) meseci, koja zajedno sa fazom obuke ne traje više od jedne (1) godine.</p> <p>6. Za vreme probnog rada, operativnom radniku se daju periodične ocene od strane nadzornika. Na kraju probnog perioda, vrši se konačna procena dostignuća zaposlenog.</p> <p>7. Na kraju probnog perioda, na predlog nadzornika, izvršni direktor odlučuje o:</p> <p>7.1. Potvrđivanju zaposlenog kao deo strukture, nakon što se procenjuje da je sposoban da preuzme odgovornost za ostvarivanje zadatka (ishod čega je potpisivanje trajnog akta o radnom odnosu);</p> <p>7.2. Otpuštanju zaposlenog kao deo</p>
--	--	--

<p>strukturës, pasi që ai vlerësohet i pa aftë për të marrë për sipër detyrat (rezulton shkëputja e kontratës dhe Kryeshefi Ekzekutiv duhet t'ia komunikojë me shkrim arsyet e zgjidhjes së saj).</p> <p>8. Në rast të shkeljes disiplinore gjatë periudhës provuese, ai do të procedohet në përputhje me Udhëzimin Administrativ për përcaktimin e shkeljeve, masave disiplinore dhe procedurës disiplinore ndaj punonjësve të IPK-së.</p>	<p>part of the structure, since he/she is evaluated unable to get above the tasks (resulting in termination of the contract and the Chief Executive Officer shall communicate in writing the grounds for such termination).</p> <p>8. In case of acting contrary to the disciplinary rules during the probationary period, he shall proceed in accordance with the Administrative Instruction for determining violations, disciplinary measures and disciplinary proceedings against employees of KPI.</p>	<p>strukture, nakon što se procenjuje da nije sposoban da preuzme odgovornost za ostvarivanje zadataka (ishod čega je raskid ugovora i izvršni direktor treba da mu napisмено obaveštava razloge za raskid).</p> <p>8. U slučaju disciplinskog prekršaja tokom probnog perioda, postupiće se u skladu sa Administrativnim uputstvom o utvrđivanju prekršaja, disciplinskih mera i disciplinskog postupka prema zaposlenima u PIK.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 29</b> <b>Caktimi në vendin e punës</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 29</b> <b>Workplace assigning</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 29</b> <b>Postavljanje na radnom mestu</b></p>
<p>Pas përfundimit me sukses të periudhës provuese një (1) vjeçare, punonjësi operativ sistemohet në kuadër të strukturës përkatëse, në pozitën siç është shpallur me konkurs.</p>	<p>Upon successful completion of the probationary period of one (1) year, the operation employee is collated within the relevant structures in the position as stated in vacancy announcement.</p>	<p>Nakon uspešnog završetka probnog perioda od jedne (1) godine, operativni radnik se raspoređuje u odgovarajuću strukturu, u poziciji kao što je navedeno na konkursu.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 30</b> <b>Lëvizja e punonjësve</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 30</b> <b>Employees transfer/deployment</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 30</b> <b>Kretanje radnika</b></p>
<p>1. Punonjësi operativ i IPK-së në përputhje me nivelin që ka, mund të lëvizë dhe të caktohet në detyrë kudo brenda strukturës operative.</p> <p>2. Lëvizja e punonjësit operativ bëhet për pozicione që janë brenda të njëjtit nivel</p>	<p>An operation employee of KPI in accordance with its relevant level, he/she can move and be deployed anywhere within the operating structure.</p> <p>2. The transfer/deployment of the operation employee shall be done only in positions that</p>	<p>1. Operativni radnik PIK-a u skladu sa nivoom kojeg ima, može da se kreće i bude određen za obavljanje dužnosti bilo gde u okviru operative strukture.</p> <p>2. Kretanje operativnog radnika se vrši za položaje koji su na istom organizacionom</p>

<p>organizativ.</p> <p>3. Lëvizja e punonjësit operativ bëhet në rastet e mëposhtme:</p> <p>3.1. Për nevoja operative të organizatës;</p> <p>3.2. Kur ekziston një situatë reale e rrezikshme ndaj jetës dhe familjes së tij;</p> <p>3.3. Me kërkesën e tij;</p> <p>3.4. Kur nuk arrin nivelin e nevojshëm të kryerjes së detyrave bazuar në vlerësimin e rezultatit të punës;</p> <p>3.5. Kur është e nevojshme që në një divizion a departament, të dërgohet një punonjës për të përmirësuar performancën apo plotësuar vendin e lirë të punës.</p> <p>4. Punonjësi njoftohet me shkrim jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike para ekzekutimit të vendimit për lëvizjen dhe caktimin e tij.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 31</b> <b>Caktimi i përkohshëm në detyrë të veçantë operative</b></p> <p>1. Për nevoja pune apo për nevoja të veçanta shërbimi, punonjësi operativ përkohësisht</p>	<p>are within the same organizational level.</p> <p>3. The transfer of the operation employee is done in the following cases:</p> <p>3.1. Operational needs of the organization;</p> <p>3.2. When there is a real dangerous situation towards his/her life and family;</p> <p>3.3. At his request;</p> <p>3.4. When it reaches the necessary level to the duties performance based on work results evaluation;</p> <p>3.5. When necessary in a division or department, an employee shall be sent in order to improve the performance or filling of vacant jobs.</p> <p>4. The employee is notified in writing no later than ten (10) calendar days prior to the execution of the decision on his transfer and assignment.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 31</b> <b>Temporary assignment into a special operation tasks</b></p> <p>1. The operation employee due to working or special service needs may be temporally</p>	<p>nivou.</p> <p>3. Kretanje operativnog radnika se vrši u sledećim slučajevima:</p> <p>3.1. Za operative potrebe organizacije;</p> <p>3.2. Kada postoji realna situacija opasna po njegovom životu i njegovu porodicu;</p> <p>3.3. Na njegov zahtev;</p> <p>3.4. Kada ne dostiže nivo potreban za obavljanje dužnosti na osnovu procene rezultata rada;</p> <p>3.5. Kada je potrebno da u jednoj diviziji ili departmanu, bude poslat zaposleni radi poboljšanja učinka ili da popunjava slobodno radno mesto.</p> <p>4. Zaposleni se pismeno obaveštava, najkasnije od deset (10) kalendarskih dana pre izvršenja odluke o njegovom kretanju i raspoređivanju.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 31</b> <b>Privremeno raspoređivanje na posebnu operativnu dužnost</b></p> <p>1. Za potrebe posla ili za posebne potrebe usluživanja, operativni radnik može da bude</p>
---	--	---

<p>mund të caktohet në detyrë të veçantë. Kjo mund të ndodhë kur Kryeshefi Ekzekutiv vlerëson dhe lëshon një vendim për caktim të përkohshëm në detyrë të veçantë operation të punonjësit, duke autorizuar një periudhë jo më tepër se gjashtë (6) muaj ose deri në përfundimin e çështjes së caktuar.</p> <p>2. Gjatë kohës së caktimit të përkohshëm në detyrë të veçantë operative, punonjësit operativ i ruhet vendi i punës, ku merr pagën dhe benefitet tjera të parapara.</p> <p>3. Në rast të caktimit të përkohshëm në detyrë të veçantë jashtë vendbanimit, punonjësit operativ i kompensohen shpenzimet e transportit, ushqimit dhe në raste kur zyrtarisht kërkohet edhe ato akomoduese.</p> <p>4. Punonjësi operativ njoftohet me shkrim jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike para ekzekutimit të vendimit për caktim të përkohshëm në detyrë të veçantë.</p>	<p>assigned to a specific task. This may happen when the Chief Executive Officer evaluates and issues a decision to temporary assignment of employee to specific operational task, authorizing a period of not more than six (6) months or until the completion of that specific task.</p> <p>2. During the temporary assignment of the operation employee, his/her position is retained, where he/she receives the salary and other provided benefits.</p> <p>3. In the case of temporary assignment on special tasks outside the place of residence, the operation employee shall be reimbursed with all transport and food costs and accommodation costs when required.</p> <p>4. The operation employee is notified in writing no later than ten (10) calendar days prior to the execution of the decision on temporary assignment to a special task.</p>	<p>privremeno raspoređen na posebnu dužnost. To se može desiti kada izvršni direktor procenjuje i izdaje rešenje o privremenom raspoređivanju na posebnu operativnu dužnost, ovlašćenjem na period ne duži od šest (6) meseci ili do završetka određenog zadatka.</p> <p>2. Tokom privremenog raspoređivanja na posebnu operativnu dužnost, operativnom radniku se čuva radno mesto, gde uzima platu i druge predviđene beneficije.</p> <p>3. U slučaju privremenog raspoređivanja na posebnu dužnost van svog grada (naselja), operativnom radniku će biti nadoknađeni troškovi prevoza, hrane i u slučajevima kada se zvanično zahtevaju i troškovi smeštaja.</p> <p>4. Operativni radnik se napismeno obaveštava najkasnije deset (10) kalendariskih dana pre izvršenja odluke o privremenom raspoređivanju na posebnoj dužnosti.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 32</b> <b>Avancimi në pozita udhëheqëse</b></p> <p>1. Punonjësi ka të drejtë të aplikojë dhe të ngritet në pozita udhëheqëse të parapara me strukturën organizative të IPK-së vetëm pasi të ketë plotësuar kriteret e parashikuara me këtë Udhëzimi Administrativ.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 32</b> <b>Promotion to leading positions</b></p> <p>1. Employee is entitled to apply for promotion to leading positions as provided within organizational structure of KPI only after meeting the criteria set forth in this Administrative Instruction.</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 32</b> <b>Unapređenje u rukovodećim pozicijama</b></p> <p>1. Zaposleni ima pravo da aplicira i bude unapređen na rukovodećim pozicijama predviđenih u organizacionoj strukturi PIK-a tek nakon ispunjavanja kriterijuma utvrđenih ovim Administrativnom uputstvom.</p>

<p>2. Avancimi i punonjësve operativë bëhet mbi bazën e një procesi përzgjedhës, të brendshëm, merititor, të drejtë, jo diskriminues dhe transparent.</p> <p>3. Për rastet e avancimit në pozita udhëheqëse, duhet të shpallen vendet e lira të punës dhe të përmbushen kriteret sipas vendit e funksionit të punës.</p> <p>4. Qëndrimi në pozitë drejtuese është i kufizuar në kohë. Pozitat ‘udhëheqës i departamentit’ dhe ‘udhëheqës i divizionit’ janë me mandat katër (4) vjeçar, me mundësi ri-zgjedhjeje të pa kufizuar për të dy pozitat.</p> <p>5. Mundësi konkurrimi për pozitë drejtuese kanë të gjithë punonjësit operativë të IPK-së, që kanë së paku tre (3) vjet përvojë në kuadër të organizatës e që konkurrojnë për pozitë ‘udhëheqës divizioni’ dhe katër (4) vjet për pozitë ‘udhëheqës departamenti’.</p> <p>6. Për t’u zgjedhur në pozitë udhëheqëse, kandidatët brenda organizatës vlerësohen sipas këtyre kriterëve:</p> <p>6.1. Përvoja në funksione operative të IPK-së (25%);</p> <p>6.2. Përvoja e përgjithshme menaxheriale (10%);</p>	<p>2. Promotion of operation employee shall be made based on selection, merit-based, fair, non-discriminatory and transparent process.</p> <p>3. In cases of promotion to leading positions, the job vacancies shall be advertised and shall be meet the criteria for job position and function.</p> <p>4. Promotion to leading position is of fixed term. Positions such as 'Head of department' and 'Head of division' are four (4) years, with unlimited re-appointment possibility for both positions.</p> <p>5.KPI provides equal employment opportunities for all the operation employees to leading positions, who have at least three (3) years of experience within the organization while applying for 'Head of division' position, and four (4) years for 'Head of department' position.</p> <p>6. To be assigned to the leading position, candidates within the organization are evaluated by the following criteria:</p> <p>6.1. Experience in operational functions of KPI (25%);</p> <p>6.2. General management experience (10%);</p>	<p>2. Unapređenje operativnih radnika vrši se na osnovu unutrašnjeg, zasluženog, fer, ne-diskriminatornog i transparentnog procesa selekcije.</p> <p>3. U slučaju unapređenja na rukovodećim pozicijama, treba da se objavljuju slobodna radna mesta i da budu ispu njeni kriterijumi prema mestu i funkciji rada.</p> <p>4. Ostajanje na rukovodećoj poziciji je vremenski ograničeno. Pozicije „rukovodilac departmana" i „rukovodilac divizije" su mandata od četiri (4) godine, uz mogućnost ponovnog neograničenog izbora za obe pozicije.</p> <p>5. Mogućnost konkurisanja na rukovodećim pozicijama imaju svi operativni radnici PIK-a, koji imaju najmanje tri (3) godine radnog iskustva u okviru organizacije gde konkurišu za poziciju „rukovodilac divizije " i četiri (4) godine za položaj „rukovodilac departmana " .</p> <p>6. Da bi bio izabran na rukovodećem položaju, kandidati u okviru organizacije se ocenjuju po sledećim kriterijumima:</p> <p>6.1. Iskustvo u operativnim funkcijama PIK-a (25%);</p> <p>6.2. Opšte iskustvo u upravljanju (10%);</p>
--	--	---

<p>6.3. Trajnimet profesionale për fushën në të cilën konkurojnë (10%);</p> <p>6.4. Performanca në punë e treguar gjatë (2) viteve të fundit (5%), dhe</p> <p>6.5. Intervista me gojë (50%).</p>	<p>6.3. Professional training in the field in which they apply (10%);</p> <p>6.4. Performance at work shown during (2) years (5%), and</p> <p>6.5. Verbal interview (50%).</p>	<p>6.3. Stručno usavršavanje u oblasti u kojoj konkurišu (10%);</p> <p>6.4. Prikazan učinak na poslu tokom (2) zadnje godine (5%), i</p> <p>6.5. Usmeni intervju (50%).</p>
<p><b>Neni 33</b> <b>Procedura e ngritjes në pozitë</b></p>	<p><b>Article 33</b> <b>Promotion procedures</b></p>	<p><b>Član 33</b> <b>Procedura unapređenja na poziciji</b></p>
<p>1. IPK-ja nxjerrë një manual standard që përmban të gjithë formularët standard që përdoren në një proces avancimi.</p> <p>2. Procedura e avancimit në pozita udhëheqëse apo drejtuese i nënshtrohet këtyre hapave:</p> <p>2.1. Divizioni i Burimeve Njerëzore njofton me shkrim Kryeshefin Ekzekutiv të IPK-së, për autorizim të shpalljes së konkurrimit të brendshëm për avancim në pozita drejtuese;</p> <p>2.2. Divizioni i Burimeve Njerëzore shpall ngritjen në pozitë, në Faqën zyrtare dhe Tabelën e shpalljeve të IPK-së, duke caktuar afatin prej dhjetë (10) ditëve të punës për aplikim, procesin, rregullat, procedurat dhe fazat e konkurrimit;</p> <p>2.3. Kandidatët plotësojnë fletëaplikacionet</p>	<p>1. IPK issues a standard manual that contains all standard forms upon promotion procedure.</p> <p>2. The promotion procedure to leading or management positions is subject to these steps:</p> <p>2.1. The Human Resources Division shall notify, in writing, the Chief Executive Officer of KPI, for the authorization of internal vacancy for management positions;</p> <p>2.2. Human Resources Division announces the promotion, to the official website and bulletin board of the KPI, by setting a deadline of ten (10) working days for applications, the process, rules, procedures and stages upon applying for the position;</p> <p>2.3. Candidates complete the application</p>	<p>1. PIK izdaje standardni priručnik koji sadrži sve standardne obrasce koji se koriste tokom procesa unapređenja.</p> <p>2. Procedura unapređenja na rukovodećim ili upravljačkim pozicijama podleže ovim koracima:</p> <p>2.1. Divizija za ljudske resurse napismeno obaveštava izvršnog direktora PIK-a, o ovlašćenju objavljivanja internog konkursa za unapređenje na rukovodećim pozicijama;</p> <p>2.2. Divizija za ljudske resurse objavljuje unapređenje na poziciji, na službenoj stranici i na oglasnoj tabli PIK-a, postavljanjem roka od deset (10) radnih dana za podnošenje prijave, proces, pravila, procedure i faze konkurisanja;</p> <p>2.3. Kandidati popunjavaju obrasce za</p>

<p>të cilët dorëzohen bashkë me dëshmitë e kërkuara me konkurs dhe në bazë të këtij Udhëzimi;</p> <p>2.4. Fletëaplikacionet dorëzohen brenda afatit të paraparë në shpallje. Nëse pas datës së fundit për pranimin e tyre, nuk është arritur të pranohet një numër i balancuar nga aspekti etnik dhe gjinor, afati për pranim zgjatet edhe për pesë (5) ditë tjera pune;</p> <p>2.5. Divizioni i Burimeve Njerëzore i regjistron aplikacionet në Regjistrin e aplikacioneve të pranuar, në të cilin shënohet titulli i vendit të punës, data e pranimit të aplikacionit dhe emri i kandidatit;</p> <p>2.6. Kryeshefi Ekzekutiv cakton një Komision, i cili verifikon nëse ato janë plotësuar si duhet, dëshmitë janë bashkëngjitur dhe nëse aplikuesit përmbushin kriteret e aplikimit. Në këtë fazë të shqyrtimit të aplikacioneve, kandidatët do të mund të vlerësohen me maksimum 50% të pikëve të mundshme, bazuar në dokumentet e prezantuara dhe kriteret e përcaktuara të avancimit;</p> <p>2.7. Pas shqyrtimit të aplikacioneve të pranuar nga Komisioni, në bazë të pikëve të arritura nxjerret Lista e kandidatëve</p>	<p>form, submitted together with the evidence required in the vacancy announcement and based on this Instruction;</p> <p>2.4. All applications shall be submitted within the time-limit as defined within vacancy announcement. If the applications submitted within the time-limit fail to meet a balanced number of applicants in terms of ethnic and gender bases, the application submission time-limit shall be extended for five (5) more working days;</p> <p>2.5. The Human Resources Division records the applications in the Register of received applications, whereas the job title, date of receipt of the application and name of the candidate shall be written;</p> <p>2.6. Chief Executive Officer appoints a Committee to check if they are properly completed, are the evidences attached and if the applicants meet the application criteria. At this stage of the review of applications, candidates will be evaluated a maximum of 50% of all scores, based on the attached documents and the set criteria of promotion;</p> <p>2.7. After reviewing the received applications by the Committee, based on achieved scores shall issue a list of</p>	<p>podnošenje prijave koji se dostavljaju zajedno sa zatraženim dokazima konkursom i na osnovu ovog Uputstva;</p> <p>2.4. Obrasci za podnošenje prijave dostavljaju se u roku propisanom u oglasu. Ako nakon isteka roka za primanje prijave, nije postignut balansirani broj na etničkom i rodnom smislu, rok za prijem se produžava za još pet (5) radnih dana;</p> <p>2.5. Divizija za ljudske resurse vrši evidenciju u Registar pristiglih prijave, gde se navodi naziv radnog mesta, datum prijema prijave i ime kandidata;</p> <p>2.6. Izvršni direktor određuje Komisiju koja proverava ukoliko su prijave ispravno popunjene, da su dokazi priloženi i ukoliko kandidati ispunjavaju kriterijume za prijavljivanje. U ovoj fazi razmatranja prijave, kandidati će biti procenjeni sa najviše 50% mogućih bodova, na osnovu predstavljenih dokumenata i utvrđenim kriterijumima za unapređenje;</p> <p>2.7. Nakon razmatranja pristiglih prijave od strane Komisije, na osnovu ostvarenih bodova sastavlja se spisak potencijalnih</p>
--	---	--

<p>potencialë dhe secili nga ta njoftohet për pjesëmarrje në intervistën me gojë;</p> <p>2.8. Intervistës me gojë i nënshtrohen të gjithë kandidatët që kalojnë fazën e shqyrtimit paraprak të aplikacioneve dhe përmes tij vlerësohen njohuritë e kandidatëve në fushën përkatëse dhe aftësitë e tyre për të menaxhuar me situatat e ndryshme në punë dhe organizatë. Intervistimi me gojë kryhet nga Komisioni intervistues i nivelit drejtues të IPK-së. Nëse numri i anëtarëve të Komisionit intervistues është i pamjaftueshëm, përbërja e tij plotësohet me anëtarë tjerë nga MPB-ja. Mesatarja e vlerësimeve individuale të secilit anëtar të Komisionit përbën 50% të rezultatit të përgjithshëm të kandidatit;</p> <p>2.9. Pas përfundimit të intervistimit me gojë, nxjerret Lista përfundimtare e rezultateve të arritura të kandidatëve, me një rekomandim për kandidatin më të suksesshëm. Në Listën përfundimtare pasqyrohen pikët e arritura nga shqyrtimi i aplikacioneve (50%) dhe ato nga intervista me gojë (50%);</p> <p>2.10. Lista finale e rezultateve të kandidatëve i dorëzohet Kryeshefit Ekzekutiv të IPK-së, i cili autorizon shpalljen e tyre në Faqen zyrtare dhe</p>	<p>potential candidates and each of them is called for a verbal interview;</p> <p>2.8. All candidates who pass the preliminary stage of applications review shall undergo a verbal interview in order to evaluate the knowledge of candidates in the particular field and their abilities to manage different situations at work or organization. The verbal interview is conducted by the interviewing committee of KPI. If the number of the interviewing Committee members is insufficient, its structure is supplemented by other MIA staff members. The average of individual evaluation of each Committee member consists of 50% of the total score of the candidate;</p> <p>2.9. After completion of the verbal interview, the final score list of candidates is issued, with a recommendation for the most successful candidate. In the final list are presented the achieved scores upon review of applications (50%) and by the verbal interview (50%);</p> <p>2.10. Final score list of candidates submitted to the Chief Executive Officer of KPI, who authorizes their publication on the official website and bulletin board</p>	<p>kandidata i svaki od njih se obaveštava o učešću na usmenom intervjuu;</p> <p>2.8. Usmenim intervjuom podležu svi kandidati koji prolaze fazu preliminarnog razmatranja i putem toga se vrši procena znanja kandidata u odgovarajućoj oblasti i njihove sposobnosti da upravljaju u različitim situacijama na poslu i organizaciji. Usmeni intervju se nadgleda od strane Komisije za intervjuisanje upravnog nivoa PIK-a. Ako broj članova Komisije nije dovoljan, onda njen sastav se dopunjuje pripadnicima iz MUP-a. Prosek individualne procene svakog člana Komisije predstavlja 50% od ukupnog rezultata kandidata;</p> <p>2.9. Nakon završetka usmenog intervjuja, izdaje se konačni spisak kandidata sa postignutim rezultatima, sa preporukom za najuspešnijeg kandidata. Konačni spisak predstavlja postignute bodove od razmatranja prijave (50%) i usmenog intervjuja (50%);</p> <p>2.10. Konačni spisak rezultata kandidata se dostavlja izvršnom direktoru PIK-a, koji ovlašćuje njihovo objavljivanje na zvaničnoj stranici i na oglasnoj tabli PIK-</p>
---	--	---



<p>Tabelën e shpalljeve të IPK-së;</p> <p>2.11. Pas shtatë (7) ditëve kalendarike të publikimit të rezultateve, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së cakton në detyrë, duke avancuar kandidatin e rekomanduar dhe lëshon vendim për ngritjen në pozitën përkatëse, në përputhje me këtë Udhëzim.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 34</b> <b>Përfundimi i mandateve për pozita udhëheqëse</b></p> <p>1. Kohëzgjatja e mandatit në pozitë udhëheqëse (ushtrimi i mandatit) përfundon:</p> <p>1.1. Me skadimin e tij;</p> <p>1.2. Me heqjen dorë nga pozita udhëheqëse;</p> <p>1.3. Për shkak të performancës së dobët;</p> <p>1.4. Për shkak të masës së shqiptuar, të ardhur si rezultat i shkeljes disiplinore;</p> <p>1.5. Në rast të shkurtimit të vendit të punës, të ardhur si rezultat i shuarjes së pozitës;</p> <p>1.6. Në rast të ri-strukturimit të brendshëm organizativ.</p>	<p>of KPI;</p> <p>2.11. After seven (7) calendar days of the publication of the final score, Chief Executive Officer of KPI shall assign to the position by promoting recommended candidate and issues a decision for the promotion in the respective position, in accordance with this Instruction.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 34</b> <b>End of mandate in leading positions</b></p> <p>1. The mandate duration in leading position (mandate discharge) is ended upon:</p> <p>1.1. End of mandate;</p> <p>1.2. Resignation from leading positions;</p> <p>1.3. Poor performance;</p> <p>1.4. Imposed measure, as a result of disciplinary violation;</p> <p>1.5. Lay-off, as a result of job position cut;</p> <p>1.6. Internal organizational restructuring.</p>	<p>a;</p> <p>2.11. Nakon sedam (7) kalendarskih dana od objavljivanja rezultata, izvršni direktor PIK-a postavlja na dužnost, unapređujući preporučenog kandidata i izdaje rešenje o unapređenju na dotičnoj poziciji, u skladu sa ovim Uputstvom.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 34</b> <b>Završetak mandata na rukovodećim pozicijama</b></p> <p>1. Trajanje mandata na rukovodećim pozicijama (vršenje mandata) se završava:</p> <p>1.1. Istekom istog;</p> <p>1.2. Povlačenjem iz rukovodećih pozicija;</p> <p>1.3. Zbog lošeg učinka;</p> <p>1.4. Zbog izrečene mere, kao ishod disciplinskog prekršaja;</p> <p>1.5. Prilikom skraćanja radnog mesta, kao ishod gašenja pozicije;</p> <p>1.6. U slučaju unutrašnje reorganizacije.</p>
---	---	---

<p>2. Pas përfundimit të mandatit udhëheqës sipas paragrafit 1 të këtij neni, punonjësi i liruar bëhet pjesë e strukturës operative të nivelit zbatues.</p>	<p>2. Following the end of mandate due to provisions of paragraph 1 of this Article, the released employee becomes part of the operation structure within executive level.</p>	<p>2. Po završetku rukovodećeg mandata iz stava 1 ovog člana, otpušteni radnik postaje deo operativne strukture izvršnog nivoa.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 35</b> <b>Lëvizja në rast të tepricës së personelit</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 35</b> <b>Transfer in case of staff redundancy</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 35</b> <b>Kretanja u slučaju viška osoblja</b></p>
<p>1. Punonjësit e IPK-së që paraqiten tepricë pas ri-organizimit, suprimimit ose bashkimit të organizatës me një organizatë tjetër, do të ri-caktohen në kuadër të institucioneve zbatuese të ligjit apo institucioneve tjera shtetërore kur ekzistojnë pozita të përshtatshme.</p>	<p>1. KPI employees who appear to be redundant after the re-organization, suppression or merger of organisation with another organization, will be re-assigned within law enforcement institutions or other state institutions when there are eligible positions.</p>	<p>1. Zaposleni PIK-a koji predstavljaju višak nakon reorganizacije, suprimacije ili spajanja organizacije sa drugom organizacijom, biće ponovo raspoređeni u okviru institucija za sprovođenje zakona ili u drugim državnim institucijama ukoliko postoje odgovarajuće pozicije.</p>
<p>2. Në rast të mungesës së pozitive të përshtatshme, punonjësit tepricë të IPK-së do të jenë në përkujdesje të Qeverisë, gjegjësisht Ministrisë për Administratë Publike, e cila do të përkujdeset për ricaktimin e tyre.</p>	<p>2. If there are no eligible positions, KPI redundant employees will be under Government's responsibility, respectively the Ministry of Public Administration, which will take care of their re-assignment.</p>	<p>2. U slučaju nedostatka odgovarajućih slobodnih pozicija, višak zaposlenih PIK-a će biti pod zaštitom Vlade, odnosno Ministarstva javne uprave, koje će se pobrinuti za njihovo raspoređivanje.</p>
<p>3. Të drejtat dhe detyrimet e punonjësve tepricë të IPK-së, duke përfshirë pagat dhe trajnimin e tyre përcaktohen nga Qeveria me akt nënligjor pas propozimit të Ministrisë përgjegjëse për administratë publike dhe Ministrisë përgjegjëse për financa, nëse nuk ka marrëdhënie tjetër pune.</p>	<p>3. The rights and obligations of KPI redundant employees, including salaries and their training, are defined by the Government by a sublegal act, after proposal of the Ministry responsible for public administration and Ministry responsible for finance, if there is no position is eligible for them.</p>	<p>3. Prava i obaveze viška zaposlenih PIK-a, uključujući njihove plate i obuke se određuju od Vlada sa podzakonskim aktom, nakon predloga nadležnog Ministarstva za javnu upravu i Ministarstva odgovorno za finansije, ako nema drugog radnog odnosa.</p>

<p align="center"><b>Neni 36</b> <b>Ngritja profesionale</b></p>	<p align="center"><b>Article 36</b> <b>Professional development</b></p>	<p align="center"><b>Član 36</b> <b>Stručno usavršavanje</b></p>
<p>1. Punonjësit e IPK-së kanë të drejtë dhe janë të detyruar t'i rrisin aftësitë e tyre profesionale përmes trajnimit. Ata mund të autorizohen që të marrin pjesë në Programe trajnuese.</p> <p>2. Pjesëmarrja në Programe trajnuese është e detyrueshme dhe konsiderohet si vijim i punës së rregullt dhe mbikëqyrësit janë përgjegjës për të lehtësuar dhe përkrahur pjesëmarrjen e punonjësve në këto programe.</p> <p>3. Trajnimet për të gjitha pozicionet në kuadër të strukturës organizative mund të jenë:</p> <p>3.1. Themelore;</p> <p>3.2. Të avancuara;</p> <p>3.3. Të specializuara, dhe</p> <p>3.4. Menaxheriale.</p> <p>4. Programet e trajnimit duhet të jenë në përputhje me Planin e Trajnimit të zhvilluar nga Divizioni i Burimeve Njerëzore, të miratuar nga Kryeshefi Ekzekutiv, sipas nevojave të organizatës.</p>	<p>1. KPI employees are entitled and obliged to develop their professional skills through training. They may be authorized to undergo training programs.</p> <p>2. Participation in training programs is mandatory and is considered as continuation of regular employment, and supervisors are responsible to facilitate and support employees' participation in these programs.</p> <p>3. Trainings for all positions within the organizational chart may be:</p> <p>3.1. Basic;</p> <p>3.2. Advanced;</p> <p>3.3. Specialized, and</p> <p>3.4. Managerial.</p> <p>4. Training programs must be in compliance with the Training Plan developed by Human Resources Division, adopted by the Chief Executive, according to the organization needs.</p>	<p>1. Zaposleni u PIK imaju pravo i obavezni su da se stručno usavršavaju kroz obuku. Oni mogu biti ovlašćeni da učestvuju u programima obuke.</p> <p>2. Učešće u programima obuke je obavezno i smatra se kao obavljanje redovne dužnosti a nadzornici su odgovorni da olakšavaju i podržavaju učešće zaposlenih u ovim programima.</p> <p>3. Obuka za sva radna mesta u okviru organizacione strukture može biti:</p> <p>3.1. Osnovna;</p> <p>3.2. Unapređena;</p> <p>3.3. Specijalizovana i</p> <p>3.4. Za rukovođenje.</p> <p>4. Programi obuke moraju biti u skladu sa planom obuke pripremljen od Divizije za ljudske resurse, odobren od strane izvršnog direktora, prema potrebama organizacije.</p>

<p>5. Për realizimin e programeve trajnuese, Kryeshefi Ekzekutiv mund të nënshkruajë marrëveshje të përbashkët me drejtuesit e institucioneve brenda vendit, si dhe homologë të huaj të vendeve partnere.</p>	<p>5. For the realization of training programs, the Chief Executive may sign common agreements with the heads of local institutions, and foreign counterparts of partner countries.</p>	<p>5. Za realizaciju programa obuke, izvršni direktor može potpisati zajednički sporazum sa domaćim institucijama kao i stranim partnerima iz partnerskih zemalja.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 37</b> <b>Vlerësimi i punës së punonjësve</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 37</b> <b>Employees performance evaluation</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 37</b> <b>Procena rada zaposlenih</b></p>
<p>1. Vlerësimi i rezultateve në punë kryhet me qëllim të rritjes së efikasitetit të punës, për të përmirësuar aftësitë profesionale dhe cilësinë e shërbimeve.</p>	<p>1. The performance evaluation is conducted in order to extend the work efficiency, improve professional skills and quality of services.</p>	<p>1. Procena rezultata na poslu se vrši u cilju povećanja efikasnosti rada, poboljšanja stručnih sposobnosti i kvaliteta usluga.</p>
<p>2. Çdo punonjës i IPK-së vlerësohet çdo vit, për periudhën nga 1 janari deri më 31 dhjetor.</p>	<p>2. All KPI employees are evaluated on yearly bases, starting from 1 january to 31 december.</p>	<p>2. Svaki zaposleni u PIK-u se ocenjuje svake godine za period od 1 januara do 31 decembra.</p>
<p>3. Për vlerësimin e rezultateve të punës perdoret formulari standard i vlerësimit, që përmbanë kriteret e vlerësimit dhe sistemin e notimit prej 1 deri në 5.</p>	<p>3. Standard evaluation forms, which contains the evaluation criteria and scoring system in a scale from 1 to 5, are utilised upon performance evaluation.</p>	<p>3. Za procenu rezultata rada koristi se standardni obrazac za procenu koji sadrži kriterijume za procenjivanje i sistem ocenjivanja od 1 do 5.</p>
<p>4. Vlerësimi i rezultateve në punë mbështetet në verifikimin e realizimit të objektivave të caktuara në fillim të periudhës së vlerësimit.</p>	<p>4. The performance evaluation is based on achievement of objectives/targets set at the beginning of the evaluation period.</p>	<p>4. Procena rezultata rada se zasniva na proveru postizanja postavljenih ciljeva na početku perioda procene.</p>
<p>5. Vlerësimi i rezultateve të punës është obligativ për mbikëqyrësit dhe mosrealizimi i tij mund të përbëjë shkak për fillimin e procedurës për masë disiplinore.</p>	<p>5. Performance evaluation is mandatory for supervisors and failure to conduct may lead to the disciplinary measure.</p>	<p>5. Procena rezultata rada je obavezna za nadzornika i ovakvo ne-ostvarivanje može predstaviti razlog za pokretanje disciplinske mere.</p>
<p>6. Vlerësimet dorëzohen në Divizionin e Burimeve Njerëzore deri më 15 janar të vitit</p>	<p>6. Performance evaluations are submitted to the Human Resources Division until January</p>	<p>6. Procene rezultata rada se dostavljaju Diviziji za ljudske resurse do 15. januara</p>

